

VENDIM
Nr. 248, datë 29.9.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “EGNATIA HYDROPOWER” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et: “GOSTIMA 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 3047 kw; “GOSTIMA 2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 5586 kw; “GOSTIMA 3”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 5335 kw; “GOSTIMA 4”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 7396 kw; “GOSTIMA 5”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 10321 kw, “GOSTIMA 5/1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 450 kw; DHE “GOSTIMA 6”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 16819 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 48 864 kw

(Ndryshuar me vendimin nr. 231, datë 30.9.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pika 3, dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave”, në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1625/2 prot., datë 26.9.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Egnatia Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: ‘Gostima 1’, me kapacitet të instaluar 3047 kw; ‘Gostima 2’, me kapacitet të instaluar 5586 kw; ‘Gostima 3’, me kapacitet të instaluar 5335 kw; ‘Gostima 4’, me kapacitet të instaluar 7396, ‘Gostima 5’, me kapacitet të instaluar 10321 kw; ‘Gostima 5/1’, me kapacitet të instaluar 450 kw; dhe ‘Gostima 6’, me kapacitet të instaluar 16819 kw, me kapacitet total të instaluar 48 864 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 120, datë 24.5.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 70/21 prot., datë 24.5.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 5.7.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Duke qenë se nga shoqëria nuk u plotësua i gjithë dokumentacioni i aplikimit, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 211, datë 17.8.2022, vendosi të shtyjë me 30 ditë pune vendimmarrjen e tij për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në mënyrë që t’i jepej mundësia shoqërisë për të plotësuar pjesën e mbetur të dokumentacionit.

- Në vijim të sa më sipër, shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k. ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e këtij aplikimi, në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Duke qenë se aktualisht rregullimi pronësor është bërë nëpërmjet kontratave të qirave afatgjata (që i shërbejnë edhe ndërtimit të HEC-eve), në përfundim të afatit të tyre (kontratë qiraje nr. 782, datë 9.4.2021, me Bashkinë Përrenjas, afati i përfundimit, datë 25.3.2031; kontratë qiraje nr. 2449, prot., datë 29.4.2021, me Bashkinë Librazhd, afati i përfundimit 7.1.2031 dhe kontratë qiraje nr. 2589 prot., datë 10.6.2021, afati i përfundimit 31.12.2030), do t’i kërkohet shoqërisë t’i depozitojë të rinovuara në ERE, apo të përcjellë çdo dokument tjetër që mund të rregullojë pronësinë në vijim.

- Kontrata e Koncesionit e formës BOT (ndërtim-operim-transferim), për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Gostimë (Egnatia–Shushicë), me nr. 4 rep., nr. 1 kol., datë 20.2.2013, ka një afat 35-vjeçar. ERE në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet, por në rast të konstatimit të humbjes së periudhës së koncesionit, licenca do të jepet për periudhën e mbetur të koncesionit. Në rastin konkret, periudhës së koncesionit i kanë mbetur 25 vjet e 5 muaj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Gostima 1”, me kapacitet të instaluar 3047 kw; “Gostima 2”, me kapacitet të instaluar 5586 kw; “Gostima 3”, me kapacitet të instaluar 5335 kw; “Gostima 4”, me kapacitet të instaluar 7396 kw; “Gostima 5”, me kapacitet të instaluar 10321 kw; “Gostima 5/1”, me kapacitet të instaluar 450 kw; dhe “Gostima 6”, me kapacitet të instaluar 16819 kw, me kapacitet total të instaluar 48 864 kw, për një afat 25 vjet e 5 muaj.

2. *Shfuqizuar.*

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti